

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: BEHAR RAMA B.I., Xhelal Hajda Toni P.n, 21000, RAHOVEC Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	11.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **11.09.2023**, nga Operatori Ekonomik: **BEHAR RAMA B.I.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME REKUIZITA SPORTIVE PËR SHKOLLA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-7418-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-055-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuare Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BEHAR RAMA B.I.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME REKUIZITA SPORTIVE PËR SHKOLLA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-7418-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-055-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin e prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **BEHAR RAMA B.I.** me adresë në **Rahovec**, me datë: **11.09.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME REKUIZITA SPORTIVE PËR SHKOLLA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-7418-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-055-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-ës të publikuar me **07.09.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

- Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 1, citoj:

Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: Sa i përket vendimit të AK lidhur me Letrën standarde B58 për tenderues te papërgjegjshëm - eliminuar.

*E kundërshtojmë në tersi vendimin e AK për eliminim, lidhur me letrën standarde B58, për faktin se vendimi i AK është i pa drejte, diskriminues dhe është qartësisht i pa bazuar për pretendimet e AK: **Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye të çmimit më të ulët:***

E kundërshtojmë në tersi këtë vendim arbitrar për eliminim nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit sepse është diskriminues, tendencioz dhe i pa drejte ndaj kompanisë tonë Ntp "ABETARE" - Behar Rama B.I Rahovec dhe, favorizues ndaj OE të shpërblyer me kontratë "Mebli Design" Shpk.

- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.1

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 **nuk qëndron.**

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, nëpërmjet formularit: **B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te publikuar me datë: **07.09.2023**, i ka njoftuar të gjithë Operator Ekonomik pjesëmarrës, se Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë, Operatori Ekonomik: **"MEBLI DIZAJN" SH.P.K., Xerxe, 21000, Rahovec;**

Ndërsa ju si Operator Ekonomik ju ka njoftuar me formular: **B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm**, duke cekur: *Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj [nuk qe tenderi me çmimin më të ulët] në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;*

Andaj oferta juaj konsiderohet e pasuksesshëm konform LPP-së, po ashtu pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazura.

- **Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 2, citoj:**

Faktet e rastit:

9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë prej jo më pak se 27,000.00 Euro:

Dëshmia: OE "Mebli Design" shpk ka ofruar referenca të natyrës tjetër dhe atë për "Furnizim me flamuj , shtiza dhe buqeta lulesh për aktivitete përkujtimore" me datë 04.05.2023 që referenca në fjalë është e skaduar d.m.th. ka më shumë se tri vjet nga data e publikimit të këtij aktiviteti. Duke shikuar Përshkrimin e çmimeve të këtij aktiviteti shohim se nuk ka të bëjë fare me kërkesat e Juaja.

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 **nuk qëndron**.

Ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 të LPP-ës shprehja “.....te realizuara ne tre vitet e shkuar” nënkupton Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose pune të realizuara **(përfunduar)** ne periudhën e shkuar tre vjeçare. Pra për bazë merret data e përfundimit të Kontratës **dhe jo e** Publikimit të Kontratës apo fillimit të realizimit të Kontratës.

Megjithatë Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë vlerën e kërkuar nga AK (Kërkesën Nr. 1 të Kërkesës mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) sa i përket realizimit të kontratave për furnizime në tri vitet e fundit e ka **plotësuar dhe tejkaluar pa e marrë për bazë fare referencën me titull "Furnizim me flamuj , shtiza dhe buqeta lulesh për aktivitete përkujtimore"**.

Pra Operatori Ekonomik i rekomanduar për Kontratë kërkesën e AK e ka plotësuar dhe tejkaluar vetëm me referencat e ofruara si dëshmi për:

- a. Referenca, dt.: 08.08.2023, Furnizim me Rekuizita sportive për shkolla, Vlera: **18,214.00 €;**
- b. Referenca, dt.: 26.08.2021, Furnizim me Rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit, Vlera: **7,274.00 €;**
- c. Referenca, dt.: 14.11.2022, Furnizim me Flamuj dhe Rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit, Vlera: **16,396.50 €;**

Ku vetëm këto Referenca të NATYRËS SË NJËJTE, të prezantuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, për tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, janë: **41,884.50 €;**

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i papabazuar.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit